# Shkurt 2025

| Nr. (1) | Data e regjistrimit të kërkesës (2) | Objekti (3) | Data e kthimit të përgjigjes (4) | Përgjigja(5) | Statusi i kërkesës (6) | Tarifa (7) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4. | 03.02.2025 | Kërkese për informacion në lidhje me: Strategjinë Kombëtare aktuale për Mbrojtjen e Mjedisit. | 13.02.2025 | Në vijim të e-mail-it tuaj ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:<br>• VKM Nr. 418, datë 27.5.2020 "Për miratimin e Dokumentit te Politikave Strategjike dhe te Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve, 2020-2035";<br>• VKM Nr. 88, date 22.2.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE), 2022-2030".<br>• VKM Nr. 418, datë 27.5.2020 "Per miratimin e Dokumentit te Politikave Strategjike dhe te Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve, 2020-2035";<br>• Vendim Nr. 594, Datë 10.9.2014 "Për Miratimin E Strategjisë Kombëtare Për Cilësinë E Ajrit Të mjedisit" ,<br>• Vendim nr. 466, Datë 3.7.2019 "Për Miratimin E Dokumentit Strategjik Dhe Të Planeve kombëtare Për Zbutjen E Gazeve Me Efekt Serrë Dhe Për përshtatjen Ndaj Ndryshimeve Klimatike". | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • VKM Nr. 814, datë 31.12.2018 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Pyjet në Shqipëri, 2019–2030”.<br><br>-Po kështu ka filluar puna paraprake për hartimin e Strategjisë dhe Planit te veprimit për Biodiversitetin.<br><br>-Gjithashtu ka filluar të përgatitet me ndihmën e projektit “ Programi për mbështetjen e Mjedisit“ financuar nga SIDA Suedeze, sapo ka filluar puna për hartimin e strategjisë ndersektorialë të Mjedisit. | | |
| 5. | 13.02.2025 | Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie te informacionit dhe kopje te dokumentacionit zyrtare | 18.02.2025 | Kthyer përgjigje me shkresë | Përfunduar | 0 |
| 6. | 18.02.2025 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: Organigramën e drejtorisë/zyrës së komunikimit<br><br>2- Numrin e punonjësve me kontratë të plotë për komunikimin dhe pozicionin përkatës (p.sh.: Specialist për media/specialist për faqen e internetit / kameraman fotograf etj.).<br><br>3- Numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme për sektorin e komunikimit dhe pozicionin përkatës | 27.02.2025 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në organikën e saj nuk ka strukturë të dedikuar për komunikimin. Me ristrukturimin e përgjithshëm të gjitha institucioneve qeveritare që u realizua në vitin 2017, u hoqën nga strukturat koncepti i sektorëve të komunikimit. Po ashtu, nuk ka as punonjës me kontratë që mbulon këto çështje. Struktura e MTM ka një Këshilltar që merret me çështjet e mediave dhe sipas rasteve, publikimet bëhen, me asistencën e përfaqësuesit IT në institucion. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4- Fondin vjetor të alokuar për këtë sektor për vitet 2022, 2023, 2024, 2025 dhe mënyrën e shpërndarjes së tij (p.sh.:<br><br>Fondi i pagave, fondi për aktivitete publike etj.)<br><br>5- Sa ka ndryshuar numri i punonjësve për Drejtorinë/zyrën e komunikimit për vitet 2021, 2022, 2023, 2024, 2025. | | | | |
| 7. | 18.02.2025 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1. Mbështetur në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (2020-2035), kërkoj kopje të studimeve të fizibilitetit, të kryera në mbështetje të planeve rajonale për çdo zonë të menaxhimit të mbetjeve.<br><br>2. Për qarkun e Tiranës, ju lutem të më vini në dispozicion planin rajonal të menaxhimit të mbetjeve, me objektiva të ndara, sipas bashkive te qarkut, së bashku me Deklaratën nga titullari i Ministrisë së Mjedisit (siç Ligji Nr 52, 2013 VSM e kërkon, në nenin | | Në proces | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2 dhe 7.)<br><br>3. Bazuar në VKM 418, dt. 25. 6. 2014, ku kërkohet që njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 31 dhjetor 2020, të përgatiten për ripërdorimin dhe për riciklimin e mbetjeve (deri në 50% të sasisë së 2014), kërkoj: sa bashki kanë përfunduar ndarjen e mbetjeve sipas rrymave dhe nëse jo, çfarë masash ka marrë MTM?<br><br>4.Bazuar në kërkesat e ligjit nr. 10 463/2011, i ndryshuar, veçanërisht nenet 10-13, lidhur me hartimin e dokumenteve politike të menaxhimit të mbetjeve (plan kombëtar, rajonal, vendor), kërkoj Planin Rajonal të qarkut Tiranë, i cili miratohet i shoqëruar me deklaratën e titullarit të MTM. Nëse nuk është miratuar, ju lutem më jepni arsyet e mos miratimit, katër vite pas hartimit të planit kombëtar (2020 -35). | | | | |
| 8. | 25.02.2025 | Kërkesë për informacion ne lidhje me: - Raport të gjitha impianteve të përpunimit të ujërave të zeza, landfilleve të mbetjeve të ngurta | | Në proces | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe kushteve të funksionimit të tyre deri nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit)<br><br>-Çfarë angazhimesh konkrete janë marrë nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit)për të garantuar pastërtinë e burimeve ujore dhe çfarë veprimesh janë marrë për të matur dhe garantuar cilësinë e ujit?<br><br>-Raporte të matjes së cilësisë së ujrave nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit).<br><br>-Çfarë reformash u zbatuan për arritjen e standardeve mjedisore evropiane dhe cili ka qenë vlerësimi i këtyre përpjekjeve nga organet e pavarura mjedisore? Çfarë renditje mban Shqipëria në rang botëror për sa I përket cilësisë së mjedisit ajrit dhe ujit nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit)?<br><br>-A mund të tregoni në detaje masat e marra për ndalimin e përdorimit të vajit D2. Kur ka ndodhur | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndalimi i tij, çfarë ndikimi ka pasur kjo në cilësinë e ajrit?<br><br>-Si i ka monitoruar dhe matur qeveria nivelet e ndotjes në ajër nga viti 2000 deri në vitin 2025<br><br>(specifikisht sipas secilit vit)? Jeni të lutur të bashkëngjisni kopje të këtyre raporteve së bashku me<br><br>rezultatet përkatëse. Ku janë të vendosur matësit e cilësisë së ajrit?<br><br>-Çfarë hapash janë ndërmarrë për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe si maten ato? Kopje të rezultateve të tyre.<br><br>-Çfarë të dhënash specifike disponohen në lidhje me reduktimin e eksporteve të lëndës drusore të papërpunuar dhe si ka ndikuar kjo në përpjekjet për ruajtjen e pyjeve?<br><br>-Të dhëna mbi sipërfaqen pyjore të Shqipërisë nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit). | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | -A ka Shqipëria sot një inventar të pyjeve? Kur ka hyr në zbatim? Jeni të lutur të bashkëngjisni të dhënat e këtij inventari.<br><br>-Kopje të strategjisë kombëtare të hartuar për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, duke përfshirë afatet kohore për zbatimin.<br><br>-A është bërë ri inventarizimit i pyjeve kombëtare. Nëse po çfarë veprimesh janë ndërmarrë në bazë të këtij inventarizimi?<br><br>-Çfarë programesh janë zhvilluar për pyllëzimin dhe si financohen dhe monitorohen? Jeni të lutur të bashkëngjisni të dhënat e këtyre programeve.<br><br>- Kopje të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të zonave të mbrojtura (ZM), Parqeve Kombëtare(PK), Rezervateve Natyrore Strikt (RNS). Kur u hartua ky plan? Kopje të rezultateve nga zbatimi i tij.<br><br>-Çfarë nismash specifike janë ndërmarrë për të reduktuar | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përdorimin e qeseve plastik dhe si monitorohet efektiviteti i tyre? | | | | |

**Shënim:**

Regjistri përditësohet çdo muaj.

(1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.

(2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.

(3) Identifikohet lloji i kërkesës.

(4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

***(****Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale")*

(5) Ndihmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.

(6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.